



БОРБА  
ПРОТИВ  
ТОРТУРА И  
НЕХУМАН  
ТРЕТМАН

# RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS PËR REFORMAT NË SISTEMIN PENITENCIAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

SHKUP, 2023



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Evropian



KOMITETI I  
HELSINKIT PËR  
TË DREJTAT E  
NJERIUT



МЗМП

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut  
i përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

**Autorë:**

Prof. inordinar Dr. Angelina Stanojoska

**Lektore:**

Violeta Tançeva-Zlateva

**Përkthimi në shqip:**

Shenasi Jaji

**Viti i botimit:**

2023

**Vendi i botimit:**

Shkup

**Numri i faqeve:**

37

**Dizajni grafik:**

Masiva Creative Agency

**Tirazhi:**

100 ekzemplarë



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA NË KËTË BOTIM .....</b>	<b>4</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>QËLLIMI I RAPORTIT .....</b>	<b>7</b>
<b>MËNYRA E HULUMTIMIT .....</b>	<b>7</b>
<b>VËSHTRIM I SHKURTËR I NJË PJESE TË (REFORMAVE) TË SISTEMIT PENITENCIAR NË PERIU DHËN 2017-2023 .....</b>	<b>8</b>
<b>ANALIZË DHE PËRFUNDIME .....</b>	<b>16</b>
Tortura, trajtimi çnjerëzor dhe/ose degradues dhe/ose ndëshkimi dhe sanksionimi i punonjësve të policisë/Dhuna ndërpersonale në institucionet e vuajtjes së dënimit .....	<b>17</b>
Korrupsioni në institucionet penitenciare .....	<b>21</b>
Mbipopullimi në institucionet penitenciare .....	<b>22</b>
Trajtimi dhe risocializimi i personave të dënuar .....	<b>25</b>
Kushtet materiale në institucionet penitenciare .....	<b>31</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>33</b>
<b>LITERATURA .....</b>	<b>35</b>

# **LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA NË KËTË BOTIM**

**IED** – institucion/institucione edukative-korrektuese

**KEMDNJ** – Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

**LES** – Ligji për ekzekutimin e sanksioneve

**LPP** – Ligji për procedurën penale

**LP** – Ligji për probacion

**PPRMV** – Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**KP** – Kodi penal

**SHNK** – Shtëpi ndëshkimore-korrektuese

**CPT** – Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues

**INK** – institucion/institucione ndëshkimore-korrektuese

**OJQ** – organizata joqeveritare

**MPK** – Mekanizmi parandalues kombëtar

**PTHP NKK** – Prokuroria themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit

**RMV** – Republika e Maqedonisë së Veriut

**SHBA** – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

## HYRJE

Në kontekstin e institucioneve të vuajtjes së dënimit (institucionet penitenciare), autoritetet e burgjeve kanë detyrimin e përgjithshëm të mbrojnë personat e dënuar nga çdo lloj dhune, si dhe nga përdorimi i tepruar i forcës.

Tortura, si fenomen i pranishëm në institucionet e vuajtjes së dënimit, përfshin dhunën si një aspekt të rëndësishëm, por edhe një sërë faktorësh të tjerë, si kushtet materiale dhe mënyrën e veprimit në respektimin e të drejtave të personave të dënuar.

Dhuna në institucionet e vuajtjes së dënimit është një fenomen i vështirë për t'u përcaktuar, para së gjithash, për shkak të raportimit më të rrallë të saj. Shumë shpesh, raportimi i dhunës në institucionet ndëshkimore-korrektuese shoqërohet me hakmarrje. Situata në të cilën ndodhen personat e dënuar e ndërlikon edhe më shumë vendimin për denoncim, sepse ato janë të privuar nga liria, dhe për këtë arsye duhet të qëndrojnë në të njëjtin institucion me atë që ka kryer ose është ende duke ushtruar dhunë, një situatë, që nga ana tjetër, mundëson hakmarrjen e tij.

Për të mundësuar forcimin e mbrojtjes së të drejtave të personave të dënuar të parashikuar në nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me mjete jogjyqësore dhe vizita të karakterit parandalues, është miratuar Konventa evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut plotësohet me ekzistencën e vetë Konventës, e cila shihet përmes faktit se përmes saj themelohet një komitet i pavarur ekspertësh - Komiteti Evropian për Mbrojtjen nga Tortura dhe Trajtimet ose Ndëshkimet Çnjerëzore ose Degraduese.

Të drejtat e personave të dënuar, në përputhje me dispozitat e CPT-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, konsiderohen nga disa aspekte në fushëveprimin e nenit 3. Si rezultat, merren parasysh: kushtet e akomodimit, kushtet higjienike, veshja dhe shtrati, ushqimi, ushtrimet fizike dhe rekreacioni, kontrolli, transferimi i personave të dënuar, kujdesi mjekësor, regjimi i veçantë në burg (përdorimi i dhomës së izolimit).

Nëpërmjet raporteve të shumta për gjendjen në institucionet ndëshkimore dhe korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, CPT-ja ka evidentuar mangësi në aspektin e kushteve materiale, praktika të caktuara që hyjnë në sferën e torturës, si dhe disa probleme të tjera të rëndësishme në sistemin penitenciar.

Më tej, CPT-ja në raportet e saj të përgjithshme dhe të veçanta qysh para vitit 2018 kishte theksuar nevojën për kontroll të jashtëm civil, duke theksuar se në shumë vende mekanizmat për ankesa ose nuk ekzistojnë ose kanë mangësi. Në të njëjtën kohë rekomandohet që këto të jenë organe të jashtme tek të cilat personat e dënuar mund t'i paraqesin drejtpërdrejt ankesat e tyre.

Me ndryshimet në Ligjin për prokurorinë publike në vitin 2018, u krijua Departamenti i specializuar për ndjekjen e krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve. Ky departament është i përfshirë edhe në Ligjin e ri për prokurorinë publike të vitit 2020.

Me ndryshimet në Ligjin për Avokatin e Popullit në vitin 2018, Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, së bashku me përfaqësuesit e organizatave (shoqatave) kompetente, në kuadër të Mekanizmit të kontrollit civil, duhet të ndërmarrin veprime dhe masa për të siguruar mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave dhe të drejtave të tyre dhe të përfaqësojnë interesat e tyre në të gjitha proceset që zhvillohen në organet e administratës shtetërore, si dhe në procedimet në prokurori dhe gjykata. E gjithë kjo duhet të arrihet përmes një hetimi efikas dhe transparent të sjelljes së personave me kompetenca policore dhe pjesëtarëve të policisë së burgjeve për vepra penale gjatë kryerjes së një akti zyrtar dhe për krime të kryera jashtë shërbimit me përdorimin e kërcënimit të rëndë, forcës apo mjetet e shtrëngimit me pasojë vdekjen, lëndimin e rëndë trupor, lëndimin trupor, privimin e paligjshëm nga liria, torturën dhe trajtimin dhe dënimin tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, nëse me ligji parashikohet ndjekje penale sipas detyrës zyrtare. Por, ky Mekanizëm ende nuk është funksional, edhe pse thirrja për përzgjedhjen e organizatave kompetente që do të jenë pjesë e tij është shpallur në shkurt të vitit 2023, kurse Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë vendim për përzgjedhjen e dy shoqatave në seancën e mbajtur më 02 nëntor 2023. Mosfunksionimi i tij dhe bllokimi i miratimit të metodologjisë së punës ka zgjatur që nga viti 2019.

## **QËLLIMI I RAPORTIT**

Qëllimi i këtij raporti gjithëpërfshirës është të analizojë rezultatet e reformave të sistemit penitenciar dhe institucioneve penitenciare që filluan në vitin 2017, kryesisht në drejtim të mbrojtjes së personave të dënuar nga tortura, trajtimi ose dënimi çnjerëzor dhe/ose degradues, përmes krijimit të formave të brendshme dhe të jashtme të zbulimit, hulumtimit dhe sanksionimit të dhunës në institucionet penitenciare; por edhe në drejtim të përmirësimit të procesit të risocializimit të tyre dhe rritjes së përdorimit të masave alternative gjatë sanksionimit të autorëve të veprave penale.

## **MËNYRA E HULUMTIMIT**

Nga metodat e hulumtimit janë përdorur metodat e përgjithshme të hulumtimit, pra analiza e përmbajtjes, metoda analitike-sintetike, induktive-deduktive, si dhe metoda krahasuese.

Analiza ka përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, strategjitë, raportet e monitorimit të CPT-së, APM-së dhe Komitetit të Helsinkit, raportet e Prokurorisë Publike të RMV-së, si dhe dokumente të tjera në lidhje me reformat e sistemit penitenciar në Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe të dhënat statistikore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Entit Shtetëror të Statistikave të RMV-së.

# VËSHTRIM I SHKURTËR I NJË PJESE TË (REFORMAVE) TË SISTEMIT PENITENCIAR NË PERIUDHËN 2017 - 2023

Vizioni për sistemin penitenciar maqedonas, si segment efikas i sistemit të drejtësisë penale, ekziston edhe para miratimit të **Strategjisë së parë kombëtare** (2015-2019) për zhvillimin dhe promovimin e tij si një sistem që është në përputhje me standardet dhe rregullat ndërkombëtare për trajtimin e personave të privuar nga liria, respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe dinjitetit të personit, jo vetëm për ta, por edhe për personat nën mbikëqyrjen e probacionit.

Realizimi i synimeve të përcaktuara duhej të përmbushte misionin, i cili, nga ana tjetër, kishte për qëllim veprimin profesional dhe efikasitetin në funksionimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit, përmbushjen e synimeve të tre “R-ve”, pra risocializimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të personave të dënuar në komunitet pas vuajtjes së dënimit me burgim, mbrojtjes së jetës, integritetit trupor, sigurisë dhe të drejtave gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, por edhe funksionimit përfundimtar të shërbimeve të probacionit dhe aplikimit të masave alternative që janë zëvendësimi më i mirë për dënimin me burgim dhe zgjidhjen e përhershme të problemit të mbipopullimit të institucioneve të vuajtjes së dënimit, përkatësisht numrit më të madh të personave të dënuar<sup>1</sup> se sa kapaciteti zyrtar i disa institucioneve të caktuara ndëshkimore-korrektuese. Këtë e thekson edhe Departamenti Amerikan i Shtetit në Raportin e tij për të Drejtat e Njeriut për vitin 2022, në të cilin thekson se mbipopullimi është ende problem në disa institucione ndëshkomore-korrektuese, duke vënë në dukje para së gjithash SHNK Idrizovë. (North Macedonia Human Rights Report, 2022: 3<sup>2</sup>).

---

<sup>1</sup> Përgjigja e Qeverisë së RMV-së pas Raportit të CPT-së nga 07-10.12.2020. <<https://rm.coe.int/1680a359cd>> [05.11.2023]

<sup>2</sup> North Macedonia Human Rights Report 2022. <[https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610\\_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf)> [01.11.2023]



Por pavarësisht hyrjes në fuqi të masave alternative në sistemin e sanksioneve që nga viti 2004, gjykatat në politikën e tyre penale nuk i identifikojnë sanksionet e punës në dobi të përgjithshme dhe dënimin me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, duke iu përmbajtur shqiptimit të shpeshtë të paralajmërimit gjyqësor dhe dënimit me kusht. Në këtë drejtim është hartuar një **Strategji e veçantë për zhvillimin e shërbimit të probacionit për periudhën 2013-2016**.

Nga viti 2017, me ndryshimet në **Ligjin për prokurorinë publike** ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" 198/18), në kuadër të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit është themeluar Departamenti i veçantë për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve.

Ky departament ekziston edhe në Ligjin e ri për Prokurorinë Publike ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" 42/20).

Në janar të vitit 2018 u miratua **Ligji për amnisti** ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" 18/11), i cili rregullonte lirimin nga vuajtja e dënimit me burg të personave të dënuar me dënim të formës së prerë me burgim për krime të përcaktuara me Kodin Penal apo ligje të tjera, të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar ose nuk kanë filluar me vuajtjen e dënimit me burg në institucionet e vuajtjes së dënimit; si dhe personave të dënuar me dënim të formës së prerë me burgim për krime të parapara me ligjet penale të një vendi tjetër, nëse autori i veprës penale është shtetas i RMV-së dhe është duke vuajtur dënimin në RMV, në bazë të ekzekutimit të dënimit penal nga gjykata e huaj apo ndërkombëtare dhe e njëjta njihet me aktgjykim të gjykatës kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Amnistia i referohej veprave të kryera penale deri më 20 shtator 2017 dhe nuk mbulonte disa vepra penale (vrasje, neni 123); vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit, vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor; veprat penale kundër shtetit; veprat penale kundër rendit dhe qetësisë publike; veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare), si dhe personat e dënuar me burgim të përjetshëm.

Gjatë asaj periudhe u theksua se miratimi i këtij ligji duhet të ndihmojë në uljen e numrit të të dënuarve të akomoduar në institucionet e vuajtjes së dënimit, gjë që do t'i përgjigjej problemit të mbipopullimit të personave të

dënuar, numri i të cilëve shpeshherë është më i madh se numri i kapaciteteve akomoduese të institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Me këtë ligj janë liruar plotësisht 576 të dënuar, ndërsa 1560 personave të dënuar u është ulur dënimi me burg për 30%.

Me ndryshimet në **Ligjin për Avokatin e Popullit** ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" 60/03, 114/09, 181/16, 189/16, 35/18) të vitit 2018 ishte parashikuar krijimi i Mekanizmit të Kontrollit Civil, në të cilin, përveç Avokatit të Popullit, do të përfshiheshin edhe tre anëtarë të jashtëm nga shoqatat me mandat njëvjeçar. Më 02.11.2023, Kuvendi i RMV-së në seancë plenare mori vendim për përzgjedhjen e dy shoqatave që do të jenë pjesë e këtij organi, përkatësisht Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, edhe pse vendimi për shpalljen e konkursit për aplikim për shoqatat është nga shkurti i vitit 2023.

Mbrojtja e personave të dënuar realizohet duke marrë masa për të ndihmuar, mbështetur dhe mbrojtur personat e dënuar dhe të drejtat e tyre, si dhe me paraqitjen e interesave të tyre në procedimet para administratës shtetërore, prokurorisë dhe gjykatave, në rastet kur pjesëtarët e policisë së burgjeve dhe personat me kompetenca policore kanë kryer vepra penale gjatë kryerjes së një veprimi zyrtar dhe për vepra penale të kryera jashtë shërbimit me përdorimin e kërcënimit të rëndë, forcës ose mjeteve të shtrëngimit me pasojë vdekjen, lëndimin e rëndë trupor, lëndimin trupor, heqjen e paligjshme të lirisë, torturën dhe trajtime dhe dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, nëse ligji parashikon ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare.

Gjithashtu, në rast të informacionit për shkelje të mundshme të së drejtës për jetë dhe ndalimit të torturës nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të iniciojë procedurë me kërkesë të viktimave direkte/indirekte, të përfaqësuesve nga sektori i organizatave joqeveritare, por edhe me iniciativën e vet.

Në kohën e vlefshmërisë së Strategjisë së parë, në vitin 2019 është miratuar **Ligji i ri për ekzekutimin e sanksioneve**, i cili ka lënë jashtë fuqisë ligjin e mëparshëm të miratuar në vitin 2006 dhe që atëherë është ndryshuar dhjetë herë. Në fakt, nevoja e miratimit të tij u konstatua edhe në Strategji si një element i rëndësishëm në procesin e sigurimit të një sistemi efikas,

profesional të institucioneve të vuajtjes së dënimit, që do të funksionojë sipas standardeve ndërkombëtare.

Faktorët kryesorë për nevojën e një ligji të ri lidheshin me nevojën për të rregulluar të gjithë sistemin për ekzekutimin e sanksioneve; krijimi i një mekanizmi të fortë dhe transparent monitorues (të brendshëm dhe të jashtëm) të sistemit të burgjeve dhe rregullimi hierarkik i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve; vendosja e një sistemi të qëndrueshëm për sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen e personave të privuar nga liria në institucionet ndëshkimore dhe edukative-korrektuese (Raporti i grupit Blueprint, 2020).<sup>3</sup>

Gjithashtu, miratimi i këtij ligji lidhej me parandalimin e autoriteteve shtetërore nga aplikimi i shtrëngimit të panevojshëm dhe joproportional; si dhe për faktin se në rastet e aplikimit të shtrëngimit ato duhet të mbështeten në dispozitat ligjore. Përkatësisht, Ligji mbron personat e dënuar nga shtrëngimi i tepruar, i paligjshëm dhe joproportional nga shteti, si dhe nga abuzimi dhe tejkalimi i kompetencave nga autoritetet shtetërore (Raporti i Grupit Blueprint, 2020).<sup>4</sup>

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve përfshin gjithashtu një mekanizëm të jashtëm kundër përdorimit të tepruar të forcës dhe mjeteve të shtrëngimit nga policia e burgjeve, në rastet kur pjesëtarët e policisë së burgjeve kanë kryer vepra penale gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare dhe vepra penale jashtë shërbimit me përdorim të forcës ose të mjeteve të shtrëngimit, me pasojë vdekjen, lëndimin e rëndë trupor ose lëndimin trupor, nëse me ligj është paraparë ndjekja penale sipas detyrës zyrtare.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për ekzekutimin e sanksioneve, më 29 maj 2019 janë miratuar 15 (pesëmbëdhjetë) **rregullore** në periudhën 2019-2020.

Ndër ato kryesore që në disa aspekte i referohen mbrojtjes së personave të dënuar nga çdo formë torture, trajtimi apo dënimi çnjerëzor dhe/ose poshtërues, si dhe procesi i trajtimit dhe risocializimit, veçohen:

---

<sup>3</sup> Raport mbi zbatimin e Strategjisë së Reformës në Drejtësi për vitin 2020. <<https://blueprint.org.mk/wp-content/uploads/2021/04/Извештај-за-спроведување-на-Стратегијата-за-реформа-на-правосудството-за-2020-1.pdf>> [15.10.2023]

<sup>4</sup> Ibid.

– **Rregullorja për kompetencat e policisë së burgjeve, mënyrën e armatosjes dhe kryerjes së detyrave të policisë së burgjeve** (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” 99/19, 220/19, 94/22), e cila i referohet kompetencave të policia e burgjeve, mënyra e armatosjes dhe kryerja e punës së policisë së burgjeve në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese.

Rregullorja trajton detyrimet që lidhen me ruajtjen e rendit dhe qetësisë në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese, duke përcaktuar saktësisht se cilat janë detyrat zyrtare të pjesëtarëve të policisë së burgjeve, mënyrën e sigurisë së jashtme dhe të brendshme, kryerjen e bastisjeve të personave dhe ambienteve, sjelljen e personave të privuar nga liria, procedurën në rast arratisjeje, llojet e armëve të policisë së burgjeve, si dhe pajisjet speciale.

→ **Rregullorja për kushtet më të afërta dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të shtrëngimit nga pjesëtarët e policisë së burgjeve në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese** (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” 99/19, 220/19, 94/22), e cila përcakton mënyrën dhe kushtet për përdorimin e mjeteve shtrënguese nga policia e burgjeve.

Në fakt, me këtë akt nënligjor rregullohet saktësisht se në cilat situata mund të përdoren mjetet e shtrëngimit për të siguruar sjelljen e disiplinuar të personave të privuar nga liria. E rëndësishme është edhe detyrimi me të cilin, për çdo përdorim të mjeteve shtrënguese, pjesëtarët e policisë së burgjeve janë të detyruar t'i paraqesin një raport me shkrim eprorit të tyre të drejtpërdrejtë. Raporti duhet të shpjegohet përmes arsyeve dhe mënyrës së përdorimit të mjeteve të shtrëngimit, si dhe të përmbajë të dhëna për personin ndaj të cilit është përdorur mjete i shtrëngimit.

→ **Udhëzimi për përcaktimin e llojeve dhe metodave të trajtimit të personave të dënuar** (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” 99/19, 220/19, 133/20), ku përcaktohen llojet dhe mënyrat e trajtimit të personave të dënuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese.

Udhëzimi përcakton metodat e trajtimit që janë kyçe në procesin e risocializimit, rehabilitimit dhe riintegrit të personit të dënuar dhe lidhen pashmangshmërisht me individualizimin e ekzekutimit të sanksioneve. Procesi i trajtimit përfshin programe të rregullta, pra masa të përgjithshme trajtimi: punë, edukim, edukim profesional, edukim moral-etik,

vetëorganizim të të dënuarve, aktivitete të kohës së lirë, sport, rekreacion të të dënuarve; si dhe programe specifike që u referohen kategorive të veçanta të personave të dënuar. Procesi realizohet nëpërmjet metodave të trajtimit individual dhe grupor.

Sigurisht, shumë e rëndësishme është edhe ndihma pas kryerjes së dënimit me burg, e cila lidhet drejtpërdrejt me rezultatet dhe suksesin e trajtimit të brendshëm, institucional. Kjo fazë e riintegritit të personit të dënuar realizohet përmes bashkëpunimit me zyrat e probacionit dhe institucionet dhe organet e tjera shtetërore nga arsimi, mbrojtja sociale dhe punësimi.

Gjatë pandemisë me koronavirusin e ri gjatë vitit 2020, përveç dekreteve me fuqi ligjore në fusha të tjera, është miratuar një **Dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve në gjendje të jashtëzakonshme**. Me të, ekzekutimi i të gjitha akteve referuese të paraqitura është shtyrë deri më 1 shtator 2020, si dhe është shtyrë nxjerrja e akteve të reja referuese nga gjyqtari për ekzekutimin e sanksioneve.

**Strategjia e re kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar për periudhën 2021-2025** vazhdoi vizionin e Strategjisë së mëparshme, duke vënë në dukje se sistemi ynë i institucioneve penitenciare dhe ndëshkimore-korrektuese duhet të avancohet në drejtim të standardeve evropiane për ekzekutimin e dënimeve me burg, masat edukative dhe masat alternative. Institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese duhet të jenë mjedise në të cilat personat e privuar nga liria do të ndihen të sigurt, do të respektohet dinjiteti i tyre, në procesin e trajtimit ata do të mund të kryejnë një shkallë të caktuar të arsimit dhe/ose trajnimit të detyrueshëm, do të marrin të plotë mbështetje në aspektin e zhvillimit personal, ata do ta shfrytëzojnë kohën e lirë në mënyrë të dobishme dhe do të ketë trajtim funksional post-penal, respektivisht ndihmë pas kryerjes së dënimit me burg (Strategjia kombëtare, 2021).<sup>5</sup>

**Në vitin 2021 u miratua Strategjia e re për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2025)**, qëllimi i së cilës është krijimi i një shërbimi të probacionit që do të punojë në

---

<sup>5</sup> Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar për periudhën 2021 – 2025. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/Национална-стратегија-за-развој-portain-10092021-MKD.pdf>> [09.10.2023]

ekzekutimin e masave alternative, që do të mundësojë riintegrimin e suksesshëm të personave të dënuar, dhe në të njëjtën kohë do të zvogëlohet numri i të dënuarve në institucionet penitenciare.

Gjithashtu, në vitin 2021 është miratuar **Strategjia për parandalimin e vetëvrasjeve në institucionet e vuajtjes së dënimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, e cila është strategjia e parë e këtij lloji. Ajo fokusohet në tre aspekte të rëndësishme që janë vendimtare për parandalimin e vetëvrasjeve të personave të dënuar: vlerësimi; ndërhyrja dhe trajtimi; dhe trajnimi.

Me ndryshimet në **Kodin Penal** të muajit shkurt 2023 (“Gazeta Zyrtare e RSM” 36/23), u ndryshuan veprat penale nga nenet 142 dhe 143. Gjegjësisht, neni 142 është riemëruar nga Maltretim dhe dënime dhe trajtime tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese në Torturë. Inkriminimi në formën bazike ka një dënim më të rreptë se më parë, pra në këtë rast minimumi pesë vjet, ndërsa më parë ishte nga tre deri në tetë, kurse teksti i veprës penale përmban më shumë veprime të ekzekutimit, ndërmarrja e së cilës do të përmbushte natyrën e veprës penale. Për dallim nga më parë, kur kishte vetëm një formë më të rëndë të veprës penale, d.m.th. kur kishte lëndim të rëndë trupor ose pasoja të tjera veçanërisht të rënda për viktimën; në ndryshimet u shtuan vdekja ose vepra penale e kryer nga urrejtja; dhe ka dy forma më të kualifikuara në të cilat ka dashje nga ana e kryesit, ndërsa pasojë është lëndimi i rëndë trupor, respektivisht vdekja. Për të tre format më të rënda, kishte dënime të larta burgimi, pra të paktën tetë, të paktën dhjetë dhe të paktën dhjetë vjet ose burgim të përjetshëm.

Vepra nga neni 143 mbetet e titulluar si Maltretim në kryerjen e shërbimit, inkriminimi i ndryshuar i të cilit përmban akte plotësuese të kryerjes së veprës penale dhe dënim më të lartë se më parë me burg, pra minimumi tre dhe maksimumi tetë vjet (ndryshe nga më parë, kur ishin parashikuar minimumi një dhe maksimumi pesë vjet).

Në mars të vitit 2023 është miratuar **Ligji për amnisti** (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” 63/23) me të cilin personat të cilët me aktgjykim të formës së prerë janë dënuar me gjobë për krimet nga neni 205 dhe neni 206 i Kodit Penal të RMV-së, të cilat janë kryer pas hyrjes në fuqi të Vendimit për konstatimin e gjendjes së jashtëzakonshme (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” 68/20) deri në

ditën e hyrjes në fuqi të ligjit, është shqiptuar dënimi me gjobë ose dënimi i zëvendësuar me burg u ishte zëvendësuar me masë alternative – dënim me kusht.

Aktualisht ekziston një **Ligj tjetër për amnisti (propozim)**, i cili nuk është votuar në procedurë të shkurtuar nga ana e deputetëve. Për sa i përket ligjit, përsëri u theksua se ai do të mundësojë uljen e numrit të të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit, të cilët kanë tejkaluar kapacitetet e disponueshme. Ngjashëm me atë të vitit 2018, ky ligj nuk do të zbatohet për personat e dënuar për vrasje (neni 123); veprat penale kundër zgjedhjeve dhe votimit; veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor; veprat penale kundër shtetit; veprat penale kundër rendit publik; veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, grabitje, mashtrim në dëm të fondeve të Bashkimit Evropian, pastrim parash dhe të ardhura të tjera nga një vepër e dënueshme penale; shpërdorimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar, punë neglizhente e shërbimit, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, dhënia e shpërblimit për ndikim të paligjshëm, marrja e shpërblimit për ndikim të paligjshëm; veprat penale të kryera gjatë dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe personat e dënuar me burgim të përjetshëm. Ligji i referohet veprave penale të kryera deri më 1 shtator 2023. Me këtë ligj pritet që 286 të dënuar të lirohen plotësisht, ndërsa 996 të dënuarve do t'u ulet dënimi me burg për 30%.

## ANALIZË DHE PËRFUNDIME

Zhvillimi i sistemit penitenciar është një parakusht i rëndësishëm për suksesin e procesit të risocializimit, rehabilitimit dhe riintegritit të personave të dënuar. Në të njëjtën kohë, një lidhje e pashmangshme me risocializimin është edhe trajtimi, së bashku me respektimin e dinjitetit të personave të dënuar dhe mbrojtjen e tyre nga çdo formë torture, trajtimi apo ndëshkimi çnjerëzor dhe/ose poshtërues. Këtu nuk nënkuptohen vetëm format e drejtpërdrejta të torturës, por edhe ato indirekte që përfshijnë mbi të gjitha kushtet materiale që ekzistojnë në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese.

Një sistem penitenciar ligjor dhe i ngritur praktikisht duhet të mundësojë trajtimin e personave të dënuar bazuar në parimin e humanizmit, mbrojtjen e interesave dhe integritetit të tyre, si dhe të krijojë kushte në institucionet penitenciare që do të jenë përafërsisht të ngjashme me ato që ekzistojnë jashtë këtyre institucioneve.

Megjithatë, pavarësisht zgjidhjes së re ligjore dhe akteve të shumta nënligjore, sistemi ka edhe më tej **dobësi** që janë problem i vazhdueshëm në procesin e përmirësimit të tij. Kjo i referohet, mbi të gjitha, problemit të mbipopullimit të institucioneve të vuajtjes së dënimit (pra, numri më i madh i të dënuarve se sa kapaciteti i institucioneve); stafi joadekuat së bashku me mungesën e stafit, mbi të gjitha, në sektorët e risocializimit; shkallë e lartë e recidivizmit (recidivizëm penologjik); kushte të këqija dhe të papërshtatshme materiale; mungesa dhe kujdesi joadekuat shëndetësor i personave të dënuar; procesi i trajtimit joadekuat dhe i pasuksesshëm i lidhur me mungesën e stafit dhe mungesën e masave kyçe të trajtimit (për shembull, angazhimi në punë dhe/ose arsimimi); problemi i kategorive të cënueshme të personave të dënuar; trajtim i keq dhe çnjerëzor nga stafi i burgut; korrupsioni. Të gjitha problemet e përmendura më parë të sistemit penitenciar janë shënuar edhe në Raportin<sup>6</sup> e fundit të Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.

---

<sup>6</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022.

<[https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/SWD\\_2022\\_337\\_7\\_EN\\_North%20Macedonia\\_MK2.doc](https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/SWD_2022_337_7_EN_North%20Macedonia_MK2.doc)>  
> [01.11.2023]



## **Tortura, trajtimi çnjerëzor dhe/ose degradues dhe/ose ndëshkimi dhe sanksionimi i punonjësve të policisë/Dhuna ndërpersonale në institucionet e vuajtjes së dënimit**

Incidenca e dhunës ndërpersonale në institucionet e burgjeve lidhet drejtpërdrejt me karakteristikat e personave të dënuar, por edhe me mjedisin e burgut, si dhe me ndërveprimin dinamik ndërmjet personave të dënuar dhe personelit të burgut, dhe lidhet me kontekstin fizik dhe social në të cilin janë vendosur të gjithë subjektet. Shumë shpesh, kufizimet fizike çojnë në uljen e rasteve të dhunës, si dhe rrezikun e sjelljes së dhunshme, por për shkak të rritjes së privimeve dhe frustrimeve, ato çojnë në humbjen e legjitimitetit dhe përshkallëzim të dhunës.

Dhuna ndërmjet personave të dënuar brenda burgjeve është ndoshta forma më e zakonshme e dhunës në institucionet e vuajtjes së dënimit. Pse? Gjegjesisht, në mjedisin e burgut ka kategori të ndryshme të personave të dënuar të cilët në një moment të jetës së tyre nuk i kanë respektuar normat e sjelljes në shoqëri, kështu që për ta sjellja e dhunshme si zgjidhje e problemeve nuk do të përbënte problem. Kërkon një përshtatje të shpejtë të rutinës së përditshme, mënyrës së funksionimit të përditshëm. Çdo problem, çdo privim, qoftë edhe dhuna, ka një kuptim më të madh në mjedisin e burgut.

Më pas është dhuna e personelit të burgut ndaj personave të dënuar, ndarja bazë e së cilës është dhuna zyrtare (që përfshin të gjitha veprimet e personelit të burgut që përfshijnë sanksione për personat e dënuar) dhe dhuna e fshehtë (të gjitha aktet e dhunshme që nuk janë të lidhura me një sanksion dhe që janë të ndaluara).

Përsa i përket mbrojtjes nga tortura, trajtimi ose dënimi çnjerëzor dhe/ose degradues i personave të dënuar, mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm, edhe pse janë të parashikuar me ligje dhe akte nënligjore, ende nuk janë efektivë, gjë që rrit mundësinë e rasteve të torturës që nuk do të regjistrohen, madje dhe nëse denoncohen nuk do të ndërmerren hapat e nevojshëm ligjorë për hetimin e rastit dhe sanksionimin e personave që kanë tejkaluar kompetencat ose janë sjellë në mënyrë të paligjshme.

Në vitin 2016,<sup>7</sup> Komiteti vuri në dukje akuza për abuzim fizik të qëllimshëm të personave të dënuar, i cili shpesh përdorej si mjet për vendosjen e disiplinës nga zyrtarët e burgut, si dënim jozyrtar për posedim të sendeve të paligjshme si telefonat celularë dhe më pas në rastet e zënkave ndërmjet personave të dënuar dhe si një përgjigje ndaj kërkesave dhe ankesave përkatëse të personave të dënuar.

Për më tepër, në vitin 2019<sup>8</sup>, Komiteti përsëri ka konstatuar se në SHNK Idrizovë ende ekziston praktika e torturës nga ana e rojeve të burgut, si dhe praktika e “rrahjes për mirëseardhje”. E njëjta gjë vlen edhe për dhunën ndërmjet vetë personave të dënuar dhe frikësimin brenda burgjeve, të cilat shpesh janë rezultat i personelit të pamjaftueshëm nëpër burgje. Është adresuar nevoja për të shtuar numrin e rojeve të burgut, trajnime për përballimin e situatave komplekse dhe përdorimin e forcës, përfshirje progresive e konceptit të sigurisë dinamike, mbikëqyrje më gjithëpërfshirëse me video, si dhe zhvillimi dhe përdorimi i planeve të trajtimit të personave të dënuar që janë të dhunshëm dhe agresivë.

Gjatë vizitave të tij në vitin 2021, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka pranuar edhe ankesa nga femra të dënuara se komandantet femra shpesh kanë përdorur forcë fizike ndaj tyre, kanë përdorur fjalë nënçmuese dhe praktika të ngjashme (Raporti i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2021<sup>9</sup>). Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar parashikon një qëllim strategjik – mbajtjen e standardizuar të evidencës/regjistrimit për rastet e dhunës dhe sigurisë në institucion, e cila prezantoi një formular dhe regjistër të standardizuar të incidenteve të dhunës në të gjitha INK-të dhe IEK-të. Gjithashtu, ekziston edhe detyrimi për paraqitje në Departamentin e specializuar për ndjekjen e krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve, i cili vepron në kuadër të Prokurorisë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

---

<sup>7</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2016. <<https://rm.coe.int/pdf/168075d656>> [07.10.2023]

<sup>8</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2019. <<https://rm.coe.int/1680a26b8f>> [07.10.2023]

<sup>9</sup> Raport nga vizitat vijuese për gjendjen dhe kushtet në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në korrik 2021. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/izveshtaj-od-posledovatelni-poseti-za-sostojbata-i-uslovitte-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-mk.pdf>> [09.10.23]

Kështu, në periudhën nga viti 2012 deri në fund të vitit 2021, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë ngritur kallëzime penale për 492 autorë, të cilët janë punonjës policie.

Sipas të dhënave statistikore të PTHPNKO-së, deri në tetor të vitit 2020 janë trajtuar 101 raste në lidhje me torturën, trajtimin dhe/ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues, ndaj 186 punonjësve të policisë, nga të cilët katër raste kanë qenë për tetë anëtarë të policisë së burgjeve; ndërsa në periudhën tetor 2020 – gusht 2021 janë ngritur raste ndaj 21 punonjësve policorë për veprën penale “Keqtrajtim dhe trajtim apo dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues” nga neni 142 i Kodit Penal të RMV-së.<sup>10</sup>

Gjatë vitit 2022, Departamenti i specializuar për ndjekjen e krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve, i cili funksionon në kuadër të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, ka proceduar kallëzime penale kundër 299 personave zyrtarëve që hyjnë në fushëveprimin e sferës së tij të punës (Raporti i PTHPRMV-së për vitin 2022, 2023: 41).<sup>11</sup>


---

<sup>10</sup> Infografikë të Komitetit të Helsinkit për krimet e kryera nga punonjësit e policisë në lidhje me torturën, trajtimin çnjerëzor ose poshtërues ose/dënimin. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/mk.pdf> & <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/10/mk.pdf>> [01.11.2023]

<sup>11</sup> Raporti i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 <[https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta\\_2022\\_2\\_mail-2-3.pdf](https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta_2022_2_mail-2-3.pdf)> [04.11.2023]

## Paraqitje grafike nr.1

### Vëllimi dhe dinamika e veprave të raportuara penale të kryera nga punonjësit e policisë



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme të RMV-së

Sipas strukturës, në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për vepra penale si shpërdorimi i detyrës zyrtare, puna e pakujdesshme, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, marrja e ryshfetit. Por ka edhe vepra penale si kontrabanda e emigrantëve, vjedhjet, falsifikimi i dokumenteve dhe deklaratave, fajdeja, spiunazhi, përgjimet e paautorizuara, shkatërrimi i pyjeve, tregtia e armëve.

Pothuajse gjysma e rasteve përfundojnë me aktakuzë, ndërsa edhe më pak me aktgjykime. Kështu, në vitin 2021 janë dhënë 50 vendime gjyqësore për persona me kompetenca policore, nga të cilët katër janë shpallur të pafajshëm, ndërsa 46 janë shpallur fajtorë (nga të cilët 36 janë dënuar me kusht, ndërsa 10 janë dënuar me vuajtje të dënimit me burg).

Megjithatë, përshtypja e përgjithshme është se Departamenti i specializuar nuk i përmbushi pritshmëritë për të cilat ishte themeluar, kryesisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në organet policore. Megjithëse nuk e minimizojmë rëndësinë e sanksionimit të punonjësve të policisë që kanë kryer vepra të tjera penale, megjithatë, shmangia e sanksionimit të personave nga poste më të larta në hierarkinë e policisë krijon terren pjellor për sjellje kriminale të punonjësve të policisë, duke përfshirë sjelljen çnjerëzore dhe korrupsionin midis punonjësve të policisë së burgjeve.

## Korrupsioni në institucionet penitenciare

Fenomenin e korrupsionit në institucionet penitenciare e konstaton edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës në raportet e tij gjatë vizitave në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kështu, në vitin 2017, Komiteti do të konstatojë se dhuna në SHNK Idrizovë është e lidhur drejtpërdrejt me korrupsionin që ekziston atje, duke filluar nga rojet e burgut, e deri te zyrtarët në poste drejtuese dhe edukatorët. Personat e dënuar kanë deklaruar se kanë paguar deri në 2000 euro për t'u zhvendosur në qeli në ambientet e strehimit kolektiv të personave të dënuar, madje dyshohet se kanë paguar 400 euro për pushim në shtëpi. Telefonat celularë ishin të pranishëm në burg, me telefona inteligjentë që kushtonin 300 euro secili, plus një pagesë të vogël ditore për punonjësit e burgut, "për të mbyllur njërin sy". Ekziston mundësia që në zhvillimin e biznesit të telefonëve celularë ka kontribuar fakti që pothuajse të gjithë telefonat me kartë "publike" nuk kanë funksionuar gjatë vizitës (Raporti i CPT-së, 2017).<sup>12</sup> Kjo situatë vazhdon edhe në dy raportet e ardhshme dhe është vërejtur nga Komisioni në vitin 2019 dhe 2020.

Për më tepër, një nga problemet kryesore që është vënë në dukje dhe ekziston ende është përkatësia politike e disa prej drejtorëve dhe zëvendësrejtorëve të institucioneve të vuajtjes së dënimit, e cila minon më tej përpjekjet për ndërtimin e një sistemi penitenciar që të jetë funksional, të mbrojë personat e dënuar dhe të mundësojë risocializimin e tyre, dhe paralelisht me këtë, jep edhe më shumë mundësi për veprime korruptive që janë praktikë e rregullt, para së gjithash, në SHNK Idrizovë.

Vërejtja mbetet ende për shkak të nevojës për emërimin e profesionistëve dhe ekspertëve në pozitat drejtuese në institucionet ndëshkimore-korrektuese. Edhe CPT-ja ka bërë të njëjtën vërejtje në raportin e vitit 2020: *"CPT-ja edhe një herë u bën thirrje autoriteteve të Maqedonisë së Veriut që të prezantojnë një model të avancimit të karrierës profesionale brenda sistemit të burgjeve, i cili do të mundësojë rekrutimin e drejtorëve dhe menaxherëve të tjerë me pozitë të lartë me qëllim të kënaqjes së*

---

<sup>12</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2019. <<https://rm.coe.int/1680a26b8f>> [07.10.2023]

*performancave të caktuara, për të pasur siguri dhe stabilitet në kryerjen e pozicionit të tyre, si dhe t'u ofrojë atyre trajnime adekuate menaxheriale në mënyrë që ata të mund të përmbushin me kompetencë detyrat e tyre."* (Raporti i CPT-së, 2020: 4<sup>13</sup>).

Në Planin Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit, drejtori i KPD Idrizovë thekson se fushat të cilave duhet t'i kushtohet vëmendje dhe në të cilat ndodhin më shpesh veprime korruptive janë, ndër të tjera, pranimi i dërgesave për personat e dënuar, zbatimi i trajtimit dhe shfrytëzimi i privilegjeve për personat e dënuar, vizitat e personave të dënuar (Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit, SHNK Idrizovë, 2023).<sup>14</sup>

Në marrjen e masave për parandalimin e shfaqjes së veprimeve korruptive ndërmjet personelit në SHNK-të dhe INK-të, po punohet për forcimin e profesionalizmit të stafit të burgjeve përmes trajnimeve të strukturuar dhe të avancuara; më tej përmes kontrolleve të sigurisë së anëtarëve të ardhshëm të policisë së burgjeve; trajnime për Kodin e Sjelljes për personelin e burgjeve; forcimi i kontrolleve në hyrje dhe dalje të objekteve të personelit dhe rritja e vëzhgimit me video; plane vjetore të rishikuara për parandalimin e korrupsionit në sistemin e burgjeve, etj.

## Mbipopullimi i institucioneve penitenciare

Një problem që ekziston prej vitesh dhe për të cilin ende nuk ka zgjidhje të përhershme është mbipopullimi i institucioneve penitenciare.

Gjatë vizitave të Mekanizmit Parandalues Kombëtar, u konstatua një teprice e të dënuarve në katër nga 11 institucionet penitenciare të vizituara, në të cilat nuk respektohet standardi minimal prej 4 m<sup>2</sup> hapësirë personale për çdo të dënuar. Problemi më i madh prej vitesh ka qenë gjendja në **SHNK Idrizovë**, ku të dënuarit flenë në korridore (ose në dyshekë të improvizuar

<sup>13</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2020. <<https://rm.coe.int/1680a359cb>> [10.10.2023]

<sup>14</sup> Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit në SHNK Idrizovë për vitin 2023. <<https://www.kpuidrizovo.gov.mk/2023/04/08/godishen-plan-za-sprechuvanje-na-korupcz%D1%98ata/>> [08.10.2023]

ose në tokë), kanë shtretër në tre kate dhe ndonjëherë flenë "me turne" (Raport i MPK-së, 2021).<sup>15</sup>

Komiteti i Helsinkit, gjatë vizitës së tij në **SHNK Prilep** në qershor të vitit 2023, konstatoi se në këtë institucion dënimin me burgim e vuajnë 132 persona të dënuar, ndërsa kapaciteti i tij është 108 persona (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2023).

E njëjta situatë është konstatuar edhe në **Burgun e Tetovës** në vitin 2021, ku në objektin me kapacitet 53 persona janë strehuar 72 persona (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2021).<sup>16</sup>

Në të njëjtën kohë, Komiteti për Parandalimin e Torturës vëren se autoritetet nuk duhet të zvogëlojnë numrin e të dënuarve përmes ligjeve për amnisti, por në një mënyrë që do të mundësojë vuajtje të qëndrueshme dhe kuptimplote të dënimit me burg. Ky do të ishte **probacioni**, i cili përfaqëson një tranzicion efektiv midis institucionit penitenciar dhe komunitetit (Raporti i CPT-së, 2019).<sup>17</sup>

Në praktikë, masat e tjera alternative, me përjashtim të dënimit me kusht, rrallë shqiptohen. Kështu, në periudhën 2017-2022, një dënim me kusht, si zëvendësim i dënimit me burg ose gjobë, është përdorur në mbi 90% të numrit të përgjithshëm të çështjeve, që lë vetëm 10% për masat e mbetura alternative, dy nga të cilat nuk janë vendosur fare gjatë asaj periudhe kohore (Tabela nr. 1).

---

<sup>15</sup> Avokati i Popullit, Mekanizmi Parandalues Kombëtar, Raporti Vjetor për vitin 2021. <<https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/NPM-dokumenti/2021/NPM%20Godisen%20izvestaj-2021.pdf>> [05.10.2023]

<sup>16</sup> Raport nga vizitat vijuese për gjendjen dhe kushtet në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në korrik 2021. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/izveshtaj-od-posledovatelni-poseti-za-sostojbata-i-uslovlite-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-mk.pdf>> [09.10.2023]

<sup>17</sup> Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2019. <<https://rm.coe.int/1680a26b8f>> [07.10.2023]

Tabela nr. 1

*Masat alternative të shqiptuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Viti	Masat alternative							
	Gjithsej	Dënim me kusht (dënim me burg)	Dënim me kusht (gjobë në para)	Dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse	Pezullimi me kusht i procedimit penal	Puna në komunitet	Vërejtje gjyqësore	Burg shtëpiak
2022	3.383	3.050	146	46	/	96	50	/
2021	3.323	2.990	218	14	/	42	59	/
2020	2.927	2.676	215	4	/	2	30	/
2019	2.526	2.412	72	/	/	/	42	/
2018	3.454	3.307	108	/	/	/	39	/
2017	3.534	3.350	138	/	/	/	46	/

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave i RMV-së

Tabela nr. 2

*Dënime të shqiptuara (burg dhe gjobë në para) në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Viti	Gjithsej (burg)	Gjithsej (gjobë në para)
2022	1.372	2.512
2021	1.176	2.742
2020	914	2.455
2019	1.181	871
2018	1.246	1.052
2017	1.255	1.381

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave



Numri i rasteve të probacionit të trajtuara nga nëntë zyrat e themeluara të probacionit ishte 451 në vitin 2021, respektivisht 475 në vitin 2022, që duhet të jetë një faktor që do të rezultojë në hapjen e katër të mbeturave nga 15 të parapara me Ligjin e probacionit (Raporti i monitorimit për probacionin, Komiteti i Helsinkit, 2023).<sup>18</sup>

Një pjesë e pengesave për vendosjen më të shpeshtë të masave alternative vërehen në ligjet e kësaj fushe, pas së cilës u theksua nevoja për ndryshime në KP, LPP, LES dhe LP, të cilat do të zgjerorin hapësirën e përdorimit të masave alternative. para së gjithash për shërbimin në komunitet dhe do të zgjatej perioda nën mbikëqyrje dhe mbështetje të personave të liruar me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse (Analiza e LES, 2023).<sup>19</sup>

Paralelisht me ndryshimet ligjore nevojiten zyrat funksionale të probacionit, shtimi i shqiptimit të masave alternative nga gjykatat, por edhe bashkëpunimi më i madh institucional në fushën e probacionit (Raporti i monitorimit të probacionit, Komiteti i Helsinkit, 2023).

## Trajtimi dhe risocializimi i personave të dënuar

Shpesh shtrohet pyetja pse procesi i risocializimit në institucionet penitenciare në RMV është kaq i pasuksesshëm dhe pse niveli i recidivizmit është kaq i lartë dhe dënimi me burg nuk e arrin qëllimin e dëshiruar, megjithëse është një sanksion penal i shtrenjtë<sup>20</sup>.

---

<sup>18</sup> Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në RMV (2021 – 2025) për vitet 2021 dhe 2022. <[https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2023/09/mk-finalen-monitoring.-probation-service-2023\\_compressed-1.pdf](https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2023/09/mk-finalen-monitoring.-probation-service-2023_compressed-1.pdf)> [06.11.2023]

<sup>19</sup> Analiza e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve: Sfidat, Problemet Praktike, Zgjidhjet, 2023. <<https://www.osce.org/files/f/documents/d/1/548914.pdf>> [05.11.2023]

<sup>20</sup> Çdo i dënuar RMV-së i kushton rreth 1000 denarë në ditë – Elena Mujoska Trpevska, Konstantin Bitrakov. Përfitimet ekonomike nga aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, Meditime ekonomike, Punim në nder të akademikut Taki Fiti, MANU 2020.

Tabela nr. 3

*Totali i të rriturve dhe të kthyerve të dënuar*

<b>Viti</b>	<b>Të rritur të dënuar</b>	<b>Recidivistë (persona të dënuar më parë)</b>	<b>Përqindja e personave të dënuar më parë (%)</b>	<b>Vepra penale të ngjashme</b>	<b>Vepra të tjera</b>	<b>Vepra të ngjashme dhe të tjera penale</b>
2022	7.769	1.541	19,8	467	694	380
2021	7.634	1.404	18,4	372	625	407
2020	6.351	995	15,7	324	393	278
2019	4.712	980	20,8	445	345	190
2018	5.857	1.242	21,2	507	497	238
2017	6.273	940	15	527	337	76

*Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave*

Siç e përmendëm në shqyrtimin e disa akteve nënligjore që janë miratuar pas miratimit të Ligjit të ri për ekzekutimin e sanksioneve, në Udhëzimin për përcaktimin e llojeve dhe mënyrave të trajtimit të personave të dënuar, janë përcaktuar metodat e trajtimit përmes të cilave përmbushen synimet e dëshiruara të procesit të risocializimit dhe riintegritit të personave të dënuar.

Sipas të dhënave nga fundi i vitit 2020, gjithsej 98 persona janë të punësuar në sektorët e risocializimit në të gjitha institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga të cilët 33 janë instruktorë, ndërsa 65 janë edukatorë (Strategjia Kombëtare [Sistemi Penitenciar], 2021 – 2025).<sup>21</sup> Në mënyrë të pashmangshme na shpie në përfundimin se ka

<sup>21</sup> Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar për periudhën 2021 – 2025.

<<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/%D0%9D%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%B2%D0%BE%D1%98-portain-10092021-MKD.pdf>> [09.10.2023]

mungesë serioze të personelit të profileve që janë vendimtare në procesin e risocializimit.

Para së gjithash duhet t'i kushtohet vëmendje aspekteve kyçe të procesit të risocializimit, d.m.th të punohet për punësimin e të dënuarve, aktivizimin e procesit arsimor dhe jo vetëm përfundimin e një niveli të caktuar arsimor të detyrueshëm, por edhe mundësinë e zhvillimit profesional dhe kompetent të personave të dënuar. Kjo është e vetmja mënyrë për të hapur mundësinë e riintegrit me të lehtë në komunitet pas përfundimit të dënimit me burg.

Duhet të mundësohet një proces i risocializimit në të cilin do të përfshihen një numër i mjaftueshëm i profesionistëve nga fusha të ndryshme shkencore. Suksesi lidhet drejtpërdrejt me vullnetin e të dënuarit, por edhe me përfshirjen e sektorit të risocializimit. Me numrin aktual të të punësuarve, praktikisht është e pamundur të zhvillohen programe adekuate të risocializimit që do t'i përgjigjen ndryshimeve të kohës moderne dhe as nuk ka një afat kohor të mjaftueshëm për të punësuarit për të punuar me çdo të dënuar individualisht.

Gjatë vizitave të CPT-së, disa persona të dënuar treguan se shumë rrallë i shohin edukatorët e tyre, gjë që tregon mungesën e stafit në departamentet e risocializimit.

**SHNK Shtip**, për shembull, ka të punësuar gjashtë persona në departamentin e risocializimit, dy prej të cilëve edukatorë, ndërsa kapaciteti i institucionit është 210 persona. E njëjta situatë është edhe në **SHNK Prilep**, ku në departamentin e risocializimit janë të punësuar vetëm 2 persona.

Mirëpo, ka institucione në të cilat numri i personave në departamentin e risocializimit është më i madh, siç është **Burgu i Kumanovës**, në të cilin ky numër është dhjetë persona. Por përkundër numrit më të madh të të punësuarve, aktivitetet në procesin e risocializimit në këtë institucion janë minimale.

Për më tepër, masat e përgjithshme të trajtimit të parashikuara nga Udhëzimi, si puna, edukimi, edukimi profesional, edukimi moral-etik, vetëorganizimi i të dënuarve, aktivitetet e kohës së lirë, sportet, rekreacioni i të dënuarve, në pjesën më të madhe nuk funksionojnë në një nivel të kënaqshëm që do të ishte e nevojshme për procesin e suksesshëm të risocializimit.

Megjithatë, **SHNK Shtip** është shembull i mirë i INK-ve ku personat e dënuar të cilët kanë shprehur dëshirën për të përfunduar shkollimin e tyre e kanë bërë këtë (45 persona të dënuar kanë përfunduar arsimin fillor, ndërsa 180 kanë marrë certifikata për profesione të caktuara).

Por gjëja më e rëndësishme që duhet theksuar është se aktualisht nuk ka arsim të përhershëm për fëmijët që vuajnë dënimin me burg dhe për fëmijët që janë dënuar me masë edukative (institucionale) - referim për akomodim në institucionet edukative-korrektuese, në të cilat arsimi është i detyrueshëm.

Sa i përket angazhimit në punë, në **SHNK Idrizovë**, shumica e të dënuarve nuk janë të angazhuar me punë, ndërsa femrat e dënuara të angazhuara në punë punojnë në institucion dhe marrin kompensim mujor prej 300 deri në 500 denarë.

Në **Burgun e Kumanovës** personat e dënuar janë të angazhuar në mirëmbajtjen e higjienës në institucion dhe rrethinë, si dhe në hapësirat e gjelbra përreth institucionit. Angazhimi është më pak se 10% e numrit total të personave të vendosur në institucion (156 në momentin e vizitës).

Megjithatë, ka edhe **shembuj pozitivë** në disa INK të caktuar. Në **SHNK Shtip** janë të punësuar një pjesë e madhe e të dënuarve (rreth 60-70 të dënuar), të cilët më së shumti merren me veprimtari bujqësore dhe blegtorale në institucion, si dhe në kuzhinë. Në **SHNK Prilep**, disa nga të dënuarit merren edhe me veprimtari bujqësore dhe blegtorale, disa me aktivitete tjera, ndërsa së shpejti pritet të funksionojë edhe punëtoria bravandreqës-mekanike dhe punëtoria e teknologjisë informatike, në kuadër të projektit të BE-së dhe Qendrës për Iniciativa Civile (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2023).

Edhe në fushën e trajtimit nuk ka programe për plotësimin e kohës së lirë të të dënuarve femra, as oborri në Pavijon nuk lejon hapësirë për ushtrime dhe rekreacion, por mjafton vetëm për shëtitje.

Janë të rralla edhe programet specifike që i referohen kategorive të veçanta të të dënuarve dhe ato që ekzistojnë janë krijuar si rezultat i projekteve të jashtme dhe ndihmës financiare të jashtme, prandaj ekzistojnë dhe zbatohen për aq kohë sa zgjat projekti dhe për aq kohë sa ka financa për to. Për fat të keq, ata nuk rifillojnë më vonë.

Strategjia kombëtare parasheh përmirësimin e kushteve dhe mundësive më të mëdha për angazhimin në punë të personave të dënuar, përmes sigurimit të pajisjeve dhe materialeve për funksionimin e punëtorive në institucionet e vuajtjes së dënimit, bashkëpunim me kompanitë dhe subjektet e tjera juridike për angazhimin në punë të personave të dënuar, si dhe bashkëpunim me institucionet dhe kompanitë tjera për arsimin profesional të personave të dënuar.

Në institucionet e vuajtjes së dënimit nevojitet akses i papenguar në **kujdesin shëndetësor**, jo zgjidhje *ad hoc* që shpesh çojnë në komplikime shëndetësore për personat e dënuar dhe rritje të kostove financiare për burgjet, të cilat mund të përdoren për të përmirësuar aspektet e tjera të vuajtjes së dënimit.

Në **SHNK Idrizovë** ende problem mbetet kujdesi shëndetësor, sepse është i vonuar dhe ka trajtim të papërshtatshëm dhe të dhunshëm ndaj personave që qëndrojnë në blloqet e burgut.

Në fakt, kujdesi shëndetësor në **SHNK Idrizovë** aktualisht ofrohet nga një mjek dhe dy infermiere të cilët nuk janë gjatë gjithë kohës, por vetëm për disa orë, për këtë arsye nuk është e mundur të ofrohen shërbime mjekësore dhe mbrojtje adekuate për të gjithë personat e dënuar që kanë nevojë për to (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2023).

I njëjti numër i personelit mjekësor, gjegjësisht një mjek dhe një stomatolog, ofrojnë kujdes shëndetësor në **SHNK Shtip**, por për një numër më të vogël të personave të dënuar.

Situata është e ngjashme edhe në **SHNK Prilep**, ku kujdesi mjekësor ofrohet nga dy infermiere, të cilët ndodhen në objekt për tetë orë në ditë (por edhe jashtë asaj kohe, nëse është e nevojshme).

Në **Burgun e Kumanovës** kujdesin mjekësor e ofron tekniku mjekësor i cili është punonjës i institucionit, ndërsa mjeku vjen dy herë në javë.

**Burgu i Tetovës** ka një mjek të punësuar rregullisht, i cili punon me orar të plotë, por institucioni nuk ka terapi të mjaftueshme mjekësore.

Personat e dënuar marrin kujdes mjekësor nga shërbimi urgjent mjekësor në **burgun e tipit të hapur në Strugë**, dhe nëse ka nevojë, një herë në javë

vjen mjeku në objekt. E njëjta situatë është vërejtur edhe në **Burgun në Manastirit** (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2020).<sup>22</sup>

Strategjia kombëtare parashikon përcaktimin e numrit minimal të personelit mjekësor të kërkuar për çdo SHNK dhe INK në RMV; motivimi i personelit mjekësor që do të punonte në institucionet e vuajtjes së dënimit; kujdes i veçantë për personat e dënuar me gjendje të veçantë mendore; trajtimi i veçantë psikosocial i personave të dënuar që abuzojnë me substanca.

Një pjesë veçanërisht e rëndësishme e procesit të trajtimit dhe risocializimit është ndihma post-penale, si formë e veçantë e trajtimit (sipas LES-it – Ndhimja për personat e dënuar pas lirimit nga institucioni).

Ndhimja pas lirimit është një grup masash dhe procedurash që zbatohen me qëllim të përfshirjes së të dënuarve të liruar në jetën e lirisë dhe konsiston në: sigurimin e akomodimit dhe ushqimit, ofrimin e trajtimit, këshillimin për zgjedhjen e vendbanimit, d.m.th. vendbanimi, pajtimi i marrëdhënieve familjare, gjetja e punësimit, kryerja e formimit profesional, dhënia e ndihmës financiare për të mbuluar nevojat më të nevojshme, si dhe forma të tjera të ndihmës dhe mbështetjes (neni 258, paragrafi 1, LES). Cila do të jetë ndihma post-penale varet nga suksesi i trajtimit në institucion.

Në RMV, sipas LES-it, Qendrat për Punë Sociale kanë mundësi për mënyra dhe forma të ndryshme të dhënies së ndihmës post-penale, por aplikojnë vetëm ndihmë të njehershme në të holla në shumë prej 4.500 denarë. Në lidhje me format e tjera, autoritetet kompetente nuk ofrojnë strehim të përkohshëm dhe sigurimin e ushqimit; asistencë për punësim etj. (Gruevska-Drakulevski, studim bazë, 2023).<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> Raporti i parë për gjendjen dhe kushtet në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën nga 1 gushti deri më 1 tetor 2020. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/izvestaj-helsinki-popravni-domovi-mk-1.pdf>> [10.10.2023]

<sup>23</sup> Situata me ndihmën post-penale dhe risocializimin në RMV (studim bazë). <[https://msp.mk/wp-content/uploads/2023/05/MK\\_Resocializacija-i-Reintegracija\\_09-07-04-2023.pdf](https://msp.mk/wp-content/uploads/2023/05/MK_Resocializacija-i-Reintegracija_09-07-04-2023.pdf)> [04.11.2023]

## Kushtet materiale në institucionet penitenciare

Një aspekt kyç i mbrojtjes nga çdo formë torture është përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve materiale në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese (penitenciare).

Kur bëhet fjalë për personat e dënuar, dokumentet ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare theksojnë një sërë aspektesh që lidhen me kushtet e strehimit të personave të dënuar si forma indirekte të torturës<sup>24</sup>.

Gjatë vizitës në vitin 2019, lidhur me kushtet materiale në SHNK Idrizovë, me përjashtim të reparteve të hapura dhe gjysmë të hapura, të cilat janë të reja, Komiteti ka konstatuar se pjesa tjetër e popullsisë së dënuar është strehuar në kushte me higjienë jo të mirë, ekziston mbipopullim, probleme me furnizimin me ujë, insekte dhe tualete të rrënuara.

Dhe në raportet e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, janë vënë në dukje një sërë mangësish në lidhje me kushtet e strehimit të personave të dënuar, para së gjithash, në SHNK Idrizovë, ku në Raportin e vitit 2023 nuk janë vërejtur ndryshime pozitive në të dy objektet ("Ndërtesa" dhe "Ambulanca", të cilat përbëjnë repartin/pavijonin e mbyllur). E njëjta gjë vlen edhe për dhomat e izolimit, në të cilat u konstatuan kushte nën standarde gjatë vizitës (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2023). Janë parashikuar 40 milionë euro për ndërtimin e një objekti të ri, i cili do të përmirësojë ndjeshëm kushtet materiale për strehimin e personave të dënuar.

Në Repartin e grave u bë një rikonstruksion me një dyshe me të re dhe dritare të reja PVC dhe panele diellore (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2021).

Mangësitë ka edhe në disa prej institucioneve të tjera të vuajtjes së dënimit në vend, si në **Burgun e Kumanovës**, ku ende ka probleme me ujësjellësin, dhomat ku strehohen të dënuarit ende nuk kanë ujë, në fakt secili repart ka vetëm nga një rubinetë.

Por ka një përmirësim të kushteve në disa prej tyre. Për shembull, janë vendosur pllaka të reja në pjesë të caktuara të institucionit në SHNK Shtip,

---

<sup>24</sup> Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights: Prisoners' rights. <[https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Guide\\_Prisoners\\_rights\\_ENG](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Guide_Prisoners_rights_ENG)> [07.10.2023]

dhe një pjesë e dhomave në repartin/pavijonin e hapur dhe gjysmë të hapur janë rinovuar. Të gjitha ambientet në repartin gjysmë të hapur janë të njëjta në të gjitha dhomat, dyert janë ndryshuar, komodat e reja dhe llambat LED. Oborri i institucionit ka një amfiteatër dhe një kopsht të punuar nga të dënuarit.

Po ashtu, në vitin 2021, në **Burgun e Tetovës** janë ndërruar dyert dhe dritaret në dhomat e të dënuarve, janë rikonstruktuar tualetet, si dhe janë blerë dyshekë dhe shtroje të reja për të dënuarit (Raporti i Komitetit të Helsinkit, 2021).<sup>25</sup>

Në **Burgun e Manastirit**, një pjesë e burgut është rikonstruktuar në vitin 2020, me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, me një kapacitet prej 83 të dënuarish.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Qeveria ka miratuar Programin për financimin e ndërtimit, rindërtimit, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjes së SHNK-ve dhe INK-ve, i cili zbatohet përmes Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.<sup>26</sup> Deri në vitin 2025 është planifikuar rikonstrukcioni i SHNK Idrizovë (faza e dytë), si dhe ndërtimi i objekteve në SHNK Prilep dhe SHNK Shtip, si dhe rindërtimi i vazhdueshëm, renovimi dhe ndërtimi i objekteve në SHNK dhe INK të tjera.

Dhe sigurisht, edhe pse po punohet për përmirësimin e kushteve materiale, kjo duhet të vazhdojë, sepse vetëm kështu do të përbushim detyrimin e respektimit të dinjitetit njerëzor në procesin e vuajtjes së dënimit me burg.

---

<sup>25</sup> Raporti i vizitave vijuese për gjendjen dhe kushtet në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në korrik 2021. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/izveshtaj-od-posledovatelni-poseti-za-sostojbata-i-uslovide-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-mk.pdf>> [09.10.2023]

<sup>26</sup> Përgjigja e Qeverisë së RMV-së pas Raportit të CPT-së nga 07-10.12.2020. <<https://rm.coe.int/1680a359cd>> [05.11.2023]; Programet vjetore të DES për vitin 2022 dhe 2023. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/Годишна-програма-на-работата-на-УИС-2022.pdf>> & <https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2023/01/Програма-за-работа-на-УИС-за-2023-година-1.pdf>> [05.11.2023]



## REKOMANDIME

- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja që do të zëvendësojnë të vjetrat, si dhe rindërtimi i kapaciteteve ekzistuese - vetëm në këtë mënyrë mund të flitet për hapin e parë drejt trajtimit dhe risocializimit të suksesshëm të personave të dënuar;
- Ulja e shkallës së personave të dënuar përmes pjesëmarrjes më të madhe të masave alternative në numrin e përgjithshëm të sanksioneve penale të shqiptuara - do të nevojiten ndryshime në legjislacionin e fushës për të zgjeruar zbatueshmërinë e masave të caktuara alternative;
- Shfrytëzimi i plotë i mundësive që ofron shërbimi i probacionit - vënia në funksionim e të gjitha zyrave të parashikuara të probacionit dhe plotësimi i tyre me staf profesional;
- Rritja e numrit të të punësuarve në departamentet e risocializimit në institucionet e vuajtjes së dënimit - në këtë mënyrë hapen mundësi më të mëdha për trajtim më të mirë, programe të trajtimit gjithëpërfshirës, komunikim shumë të shpeshtë ndërmjet punonjësve dhe personave të dënuar, që do të rezultonte me risocializim të suksesshëm, që do të çonte në ulje të shkallës së burgimit të sërishëm;
- Mundësi më të shumta dhe më të mira për angazhimin në punë të personave të dënuar – nevojitet bashkëpunim më i madh me subjektet juridike dhe me institucionet shtetërore që do të siguronin vende për angazhim në punë për disa nga personat e dënuar, gjë që do të rriste cilësinë e trajtimit; do t'u jepte personave të dënuar mundësinë për të fituar ose përmirësuar njohuritë e tyre profesionale, që do të nënkuptonte mundësi më të mëdha për punësim pas vuajtjes së dënimit me burgim;
- Përfshirja aktive dhe e plotë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në procesin e edukimit të vazhdueshëm dhe/ose mundësive për aftësim profesional të personave të dënuar - arsimimi është një nga masat kryesore të trajtimit të përgjithshëm dhe së bashku me angazhimin në punë, me zbatimin e suksesshëm, mundësojnë


- riintegrim më të lehtë në komunitetin që i përket personi i dënuar pas lëshimit nga institucionet e vuajtjes së dënimit;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për sigurimin e kujdesit shëndetësor cilësor si për shëndetin fizik ashtu edhe për atë mendor të personave të dënuar – institucionet e vuajtjes së dënimit duhet të ketë të punësuar rregullisht mjekë dhe psikologë të cilët do të jenë në dispozicion për nevojat shëndetësore të personave të dënuar; po ashtu duhet të zgjidhet problemi i sigurimit shëndetësor për personat e dënuar;
  - Programe të përhershme profesionale për trajtimin dhe rehabilitimin e kategorive vulnerabël të personave të dënuar;
  - Përbushja praktike e detyrave të qendrave të punës sociale në procesin e ndihmës postpenale të personave të dënuar, që përfshin jo vetëm ndihmën e njëfishtë financiare, por edhe ofrimin e shërbimeve të tjera sociale si asistencë për punësim, akomodim etj.;
  - Rritja e numrit të anëtarëve të policisë së burgjeve përmes punësimeve të reja dhe investimi në pajishmërinë e tyre - në këtë mënyrë do të rritej niveli i sigurisë në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe do të zvogëlohej niveli i dhunës reciproke;
  - Sanksionimi i pjesëtarëve të policisë së burgjeve, kur ata veprojnë jashtë autoritetit dhe kompetencës së tyre të dhënë nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve dhe aktet nënligjore;
  - Sanksionimi i punonjësve të institucioneve të vuajtjes së dënimit të përfshirë në veprime korruptive dhe masa parandaluese në drejtim të zhvillimeve të tilla;
  - Profesionalizimi i personelit të burgut dhe ngritja dhe trajnimi i vazhdueshëm i tij, i cili tashmë është duke u ndërmarrë pjesërisht përmes aktiviteteve të Qendrës së Trajnimit në Idrizovë.

## LITERATURA

1. Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights: Prisoners' rights. <[https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Guide\\_Prisoners\\_rights\\_ENG](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Guide_Prisoners_rights_ENG)>
2. North Macedonia Human Rights Report 2022. <[https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610\\_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2023/02/415610_NORTH-MACEDONIA-2022-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf)>
3. Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit në SHNK Idrizovë për vitin 2023. <<https://www.kpuidrizovo.gov.mk/2023/04/08/godishen-plan-za-sprechuvanje-na-korupczi%D1%98ata/>>
4. Programi vjetor i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve për vitin 2022. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2022/03/Годишна-програма-на-работата-на-УИС-2022.pdf>>
5. Programi vjetor i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve për vitin 2023. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2023/01/Програма-за-работа-на-УИС-за-2023-година-1.pdf>>
6. Gruevska-Drakulevski, A. (2023). Situata me ndihmën post-penale dhe risocializimin në RMV (studim bazë), Shoqëria Penologjike e Maqedonisë. <[https://msp.mk/wp-content/uploads/2023/05/MK\\_Resocijalizacija-i-Reintegracija\\_09-07-04-2023.pdf](https://msp.mk/wp-content/uploads/2023/05/MK_Resocijalizacija-i-Reintegracija_09-07-04-2023.pdf)>
7. Ligji për amnisti, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 11/18.
8. Ligji për amnisti, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 63/23.
9. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, „Gazeta Zartare e RMV-së“ nr.99/19, 220/19, 236/22.
10. Ligji për Prokurorinë Publike, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 42/20.
11. Ligji për Avokatin e Popullit, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 60/03, 114/09, 181/16, 189/16, 35/18.
12. Ligji për probacion, „Gazeta Zartare e RMV-së“ nr. 226/15.f
13. Raporti i Blueprint për zbatimin e Strategjisë së reformës në drejtësi 2020. <<https://blueprint.org.mk/wp-content/uploads/2021/04/Извештај-за-спроведување-на-Стратегијата-за-реформа-на-правосудството-за-2020-1.pdf>>
14. Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2022. <[https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/SWD\\_2022\\_337\\_7\\_EN\\_North%20Macedonia\\_MK2.docx](https://www.sep.gov.mk/data/file/Pregovori/SWD_2022_337_7_EN_North%20Macedonia_MK2.docx)>

15. Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2016. <<https://rm.coe.int/pdf/168075d656>>
16. Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2019. <<https://rm.coe.int/1680a26b8f>>
17. Raporti i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues për vizitën e vitit 2020. <<https://rm.coe.int/1680a359cb>>
18. Raporti i prokurorive publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022. <[https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izvestaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta\\_2022\\_2\\_mail-2-3.pdf](https://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2023/09/izvestaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta_2022_2_mail-2-3.pdf)>
19. Kodi Penal i RMV-së, „Gazeta Zartare e RMV-së“ nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18, 36/23 dhe 188/23.
20. Millosheski, A. et al. (2023). Analiza e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve: Sfida, probleme praktike, zgjidhje. <<https://www.osce.org/files/f/documents/d/1/548914.pdf>>
21. Mujoska Trpevska, E., Bitrakov, K. (2020). Përfitimet ekonomike nga aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, Meditime ekonomike, Punim për nder të Akademik Taki Fiti, MANU.
22. Avokati i Popullit, Mekanizmi Parandalues Kombëtar, Raporti vjetor për vitin 2021. <<https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/NPM-dokumenti/2021/NPM%20Godisen%20izvestaj-2021.pdf>>
23. Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015 – 2019). <[https://www.pravda.gov.mk/upload/Documents/Nacionalna\\_strategjiaMK\\_12\\_2014.pdf](https://www.pravda.gov.mk/upload/Documents/Nacionalna_strategjiaMK_12_2014.pdf)>
24. Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar për periudhën 2021 – 2025. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/Национална-стратегија-за-развој-portain-10092021-MKD.pdf>>
25. Përgjigja e Qeverisë së RMV-së pas Raportit të CPT-së nga 07-10.12.2020. <<https://rm.coe.int/1680a359cd>>
26. Rregullore për kompetencat e policisë së burgjeve, mënyrën e armatosjes dhe kryerjes së punës së policisë së burgjeve, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 99/19, 220/19, 94/22.

27. Rregullore për kushtet më të afërta dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të shtrëngimit nga pjesëtarët e policisë së burgjeve në institucionet e sistemit penitenciar, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 99/19, 220/19, 94/22.
28. Stanojoska A. (2021). Sanksionet penale dhe ekzekutimi i tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Fakulteti Juridik, Manastir.
29. Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021 – 2025). <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2023/03/%D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B1%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-2021-2025.docx>>
30. Strategjia për zhvillimin e shërbimit të probacionit për periudhën 2013 – 2016. <http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/01087/mk/Стратегија-за-развој-на-пробациска-служба.pdf>>
31. Strategjia për parandalimin e vetëvrasjeve në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. <<https://uis.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/Стратегија-за-спречување-самоубиство-во-КПУ-МК.pdf>>
32. Udhëzim për përcaktimin e llojeve dhe metodave të trajtimit të personave të dënuar, „Gazeta Zartare e RMV-së“ 99/19, 220/19, 133/20.
33. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2020). Raporti i parë për gjendjen dhe kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën nga 1 gushti deri më 1 tetor 2020, Shkup. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/izvestaj-helsinki-popravni-domovi-mk-1.pdf>>
34. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2021). Raport nga vizitat vijuese për gjendjen dhe kushtet në institucionet penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në korrik 2021, Shkup. <<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/izvestaj-od-posledovatelni-poseti-za-sostojbata-i-uslovide-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-mk.pdf>>
35. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2023). Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për zhvillimin e shërbimit të probacionit në RMV (2021 – 2025) për vitin 2021 dhe 2022, Shkup. <[https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2023/09/mk-finalen-monitoring.-probation-service-2023\\_compressed-1.pdf](https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2023/09/mk-finalen-monitoring.-probation-service-2023_compressed-1.pdf)>
36. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2023). Raporti për gjendjen dhe kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukative-korrektuese (penitenciare) në vitin 2023, Shkup.



RAPORT GJITHËPËRFSHIRËS  
**PËR REFORMAT NË SISTEMIN  
PENITENCIAR NË REPUBLIKËN  
E MAQEDONISË SË VERIUT**